Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/456
Datë: 08.07.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Rikreditohet dhe rivalidohet** Institucioni i Aftësimit Profesional "Shehu Academy" me adresë: Parku i Biznesit Drenas, 13a, Drenas 13050, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 30.12.2023 deri 29.12.2026, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1. **Zdrukthëtar**, Niveli IV i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare profesionale (D), me 31 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor dhe për një cikël trajnimi (4 mujor) mund të trajnohen 2 grupe (me dy turne), pra gjithsejtë 28 (njëzetetetë) kandidatë, numri i kandidatëve për një grup mund të jetë maksimalisht 14 (katërmbëdhjetë) kandidatë. Institucioni për një vit kalendarik mund të trajnoj në total 6 (gjashtë) grupe me gjithsejtë 84 kandidatë.

2. Obligohet Institucioni i Aftësimit Profesional "Shehu Academy" që në afat kohor prej 3-6 muaj të plotësoj infrastrukturen e nevojshme për përsonat me aftësi të kufizuara përfshirë pjerrinen me pjerrtësi deri në 6 përqind, deren për qasje me gjërësi 1.10. metër dhe me kalueshmëri pa prag, ashensori nese është e nevojshme si edhe tualetet, po ashtu institucioni obligohet të ofroj dëshmi konkrete mbi zhvillimin e politikave dhe procedurave lidhur me vlerësimin e përsonave me aftësi të kufizuara.

3. Obligohet Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve të bëjë monitorimin lidhur me plotësimin e kushteve nga ana e institucionit.

4. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni i Aftësimit Profesional "Shehu Academy" me datë 05.10.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimin zdrukthëtar niveli IV i KKK, e cila është protokolluar dhe ka marrë numër 01/578. AKK bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve dhe standardeve të përcaktuara nga AKK.
AKK ka caktuar ekipin vlerësues të eksperteve për vlerësimin e institucionit. Ekipi i ekspertëve vlerësues ka shqyrtuar dokumentacionin e institucionit me datë 13.02.2024, vizitën tek institucioni aplikues e ka realizuar me datë 15.02.2024, për të bërë vlerësimin e institucionit lidhur me procesin e riakreditimit dhe rivalidimit, ndërsa pas analizimit të dosjes dhe realizimit të vizitës tek institucioni, ekipi i eksperteve me datë 28.03.2024 ka përpiluar raportet vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim dhe i kanë rekomanduar Këshillit Drejtues të AKK-së riakreditim dhe rivalidim të institucionit për ofrim, vlerësim dhe certifikim të kualifikimit Zdrukthëtar.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve të jashtëm janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim dhe validim si institucion ofrues, vlerësues dhe certifikues i kualifikimit; Raportin e vetëvlerësimit; Vizitën e ekipit të ekspertëve në Institucionin e Aftësimit Profesional "Shehu Academy" raportet vlerësuese të ekipit të ekspertëve si dhe dokumente tjera shtesë.

Këshilli Drejtues në mbledhjen e datës 24.06.2024 ka trajtuar si pikë të rendit të ditës raportet vlerësuese të ekspertëve për institucionin "Shehu Academy" lidhur me kualifikimin Zdrukthëtar dhe bazuar nga të gjeturat në këto raporte mori vendim me të cilin obligon institucionin që në afat 3 deri 6 muaj të plotësoj infrastrukturen e nevojshme për përsonat me aftësi të kufizuar përfshirë: pjerrinen me pjerrtësi deri në 6 përqind, Deren për qasje me gjërësi 1.10. metër dhe me kalueshmëri pa prag, ashensori nese është e nevojshme si edhe tualetet, po ashtu institucioni obligohet të ofroj dëshmi konkrete mbi zhvillimin e politikave dhe procedurave lidhur me vlerësimin e përsonave me aftësi të kufizuara.

Këshilli Drejtues i Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve bazuar në legjislacioni në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së ka obliguar AKK-n të realizoj procesin e monitorimit tek institucioni "Shehu Academy" me qëllim të vlerësimit nese institucioni përmbush obligimet e përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së Institucionit për Aftësimit Profesional "Shehu Academy" për riakreditim dhe rivalidim të kualifikimit Zdrukthëtar niveli IV i KKK, rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim për institucionin aplikues si dhe nga të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. IAP "Shehu Academy"
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së